


Adim Mato

BIBLIOTEKA	E	SHITETIT
	85H-1	
	M-60	
GJIROKASTËR		



JUG

POEZI

85H-1
M-100

AGIM MATO

J U G

- POEZI -

~~53394.~~

13449

SHTËPIA BKTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë 1970

KAM SJELLE

Po vij nga jugu.

Kam sjellë me vete ç'munda të kap nga zhurmat e
jetës,
nga drita dhe relieve të gjelbëra të pranverës.

Kam sjellë ëndrra njerëzish,
dielli i shpresave të të cilëve kurrë s'u ngrit i verbër,
e kurrë këmbët s'i hoqi zvarrë nëpër mjegull.

Stuhitë jingore, kam sjellë,
portretin e peshkatarëve,
si vetë shkëmbenjtë e Jonit,
me ballin e skalitur nga mijëra stërkala
dhe rrokullisje të pashtershme dallgësh.

(Kudo që shkojnë
janë vazhdim i brigjeve dhe kopshteve të rivierës.)

Para se të vija te ju,
shtyva derën e varrezave dhe një copë herë
qëndrova më këmbë përpara heronjve.

Ula mbi ta
një tufë ditësh të freskëta.
Mora prej tyre
një tufë stuhish dhe krismash
që tani po më bubulljnë në duar.

Vij nga jugu.

SHQETËSIM PRANVEROR

Kjo mbrëmje pranvere nuk më le të largohem
për asnjë çast nga njerëzit dhe deti.

Ndjej një shqetësim të ëmbël.

S'e di përse shqetësohem,

nuk e di ç'është ky shqetësim i bardhë,
që më mbështjell zemrën.

(Di vetëm se më pëlqen, se ndihem mirë me të.)

Vërtet, përse sa herë që vjen pranvera,

sa herë që bari vesh mishin e dheut të ftohur nga
erërat,

përse sa herë që mbi qytet

ndizen këto mbrëmje jugore,

në zemrën time dynden mjegullat

e këtij shqetësimi të bardhë?

Jam biri i brigjeve të gjelbra.

Biri i rërës dhe i detit.

Fytyrën time nuk mund ta ndash kurrsesi

nga buzëqeshja e portokalleve,
nga trungjet e menduara t'ullinjve.
E kam harruar fare ditëlindjen,
siç ka harruar deti të tijën.

Nuk e di sa vjeç jam.

Nuk e di që prej sa kohësh e kam pirë
këtë dritë të kaltër,

që rrjedh sipër këtij dheu të gurtë.

Kam përshtypjen sa u mblodhën
aromat e tokës, gjithë dritat,
u mblodhën gjithë shqetësimet e detit,
vetë mendimet e ullinjve
dhe më krijuan mua.

Kam përshtypjen se jam çdo gjë
mbi këtë dhe që rrahin valët.

Ç'është që më shqetëson?

Mos ndoshta ky bar i gjelbër?

Ky qytet i ulur buzë detit si një sirenë
e sapodalë nga ujët?

Këta njerëz që përshëndesin kaq çiltër
nën freskinë e muzgjeve pranverore?

Mos ndoshta vetë bulëzimi i jetës

që shpërthen në këto brigje
me flamurin e pranverës më shqetëson?

Në zemrën time dynden mjegullat
e një shqetësimi të bardhë.

**PASHË SI PO PËRCILLNIN NË BANESËN E FUNDME
NJË VETERAN.**

Pashë si po përcillnin në banesën e fundme
një veteran,
të mbështjellë me flamuj,
si të mbështjellë
me ditë të përgjakura betejash.

Pashë shkëmbenjtë të ngriheshin mbi heshtjen
e detit
si një ngurtëzim shkumësh stuhie.

Kortezhi kalonte.
Grilat e vjetra buzë rrugës
ndjenë t'u therrnin brinjët.
Punëtorë, sekretarë organizatash, vetura të
ardhura nga larg,

ndiqnin arkivolin,
siç ndjek diellin kur perëndon,
kortezhi i heshtur i yjve.

Pastaj çdo gjë iku tutje.
Unë ngela vetëm me qetësinë e grilave.
Brodha nga një cep i vetmisë së tyre te tjetri
dhe mora prej tyre gjithshka më mungonte:

Mora në zemër gjurmët e ilegalit
të ruajtura thellë në qetësinë e grilave.
Mora vite shtërgate.

Mbi det dielli perëndoi dhe i veshi ndërtesat
me një ngjyrë të çuditshme.

SHQIPËRIA

Mijëra oxhaqe ngrihen si duar në horizont;
e me to, përshëndetjet e punëtorëve
nën natën dhe zhurmën shurdhonyjëse të maqinerive
në çastin e ndërrimit të turneve,
gazet e gazetave si rrezet e një dielli,
që përshkojnë të gjitha rrugët,
parullat me gur dhe gëlqere në ballin e maleve,
(vetë fjala jonë e skalitur në ballin e kohës),
pagëzimet e rrugëve të reja,
emrat e heronjve të rinj,
vlaga e re që ngjitet
që nga thellësitë e kësaj toke,
që nga thellësitë e shpresave të këtij populli,
çanta e projektonjësve
që mbajnë brenda gumëzhitjen e qyteteve të rinj,

që mbajnë brenda buzëqeshjen e s'ardhmes;
dhe mbi të gjitha,
Ndërtesa e komitetit qendror si një gjenerator
q'injekton pulsin e partisë
në të gjitha rrebat e këtij dheu.

PARTISË SIME

S'do të kërkoj fjalë të lëmuara,
të brishta, po fjalë
që nga kjo tokë dua t'i nxjerr si shkëmbenj,
t'i rrokullis pastaj
në themele e rreshta
dhe me to mure poemash të ngre.

Fjalët e popullit, të rëndat fjalë,
me supet e mia dua t'i stis në këngë,
ashtu si punëtorët stisin me radhë
fasadat e korpuseve të rënda.

Le të vërtiten stuhitë e kohës,
Në muret e lartë bëhen thërmia!
Mendimi yt, parti, do të jehojë parreshtur
në të gjitha oxhaqet e këngëve të mia!

KËNGA E GJELBËR

Po, ne e sollëm pranverën.
Ajo ishte ngatërruar,
Kush mund t'ja gjente fijet
përmes tymrave, predhave, gërmadhave?
Lëvizje një predhë, se mos nën të
kishte mbirë të paktën një lule,
se mos kishte mbirë një ëndërr, një shpresë.
E vije përsëri në vend.

Ku mund t'ishte pranvera? Ç'u bënë lulet?
Vetëm krismat mbillnin lule të kuqe në trupin tonë
dhe hapnin krismat
dyert e urrejtjes në zemrën tonë.

Po doli partia si ylli i mëngjezit,
buzë agimit të ri,

doli partia — i ndritshmi sy
në fytyrën e përgjakur të këtij qielli.
Me këtë sy ne shikonim
mbi kurrizin e viteve t'ardhmen.
Ku ishte pranvera
tashti fare mirë e gjenim:
Ajo lulëzonte në zemrën tonë,
për pallatet e nesërm lindnin filizat e saj.
Në qytet traktet lajmëronin shpërthimin e luleve.

KËNGA E CANO HAJDINIT

Kur u nise,
nuk harrove të ktheje kokën pas.
Sa i bukur, fshati yt!
Si ishte gdhirë ashtu n'atë mëngjez lufte
me flokët e shkujdesur të ullinjve dhe portokalleve.
Borshi yt, Cano.
Ti ktheve kokën, rrëmbimthi kape detin, kopshtet,
një mjegull të hollë,
rrëmbimthi mbushe gjoksin
me dritat e hapsirës së vendlindjes
dhe u ngjite lart.

U ngjite lart, te zjarret partizane,
si të ngjiteshe në oaze lirie.
Pas betejave mbështeteshe në shkëmbenjtë
dhe pastroje një copë herë armën tënde.
Mbështeteshe n'ëndërrimet e tua

dhe, siç prekje me dorë armën,
prekje me fantazi të nesërmen e atdheut.

Por tashti liria s'ishte më në oaze malesh.
Radhë-radhë suleshin brigadat ndaj qyteteve,
duke brohoritur,
duke ndjekur këmba-këmbës garnizonet armike,
dhe duke ndalur vetëm në krahët e gëzimit të
popullit.

Kështu duhej të brohorisje edhe ti,
kështu duhej të hyje edhe ti
në një nga qytetet e shumta.

Përpara teje qëndronte e gurtë, Gjirokastra.

Ti brohorite. U sule poshtë me shokët.
Rrugëve të ngushta të qytetit, maqina pushtonjësish
hunguronin të alarmuara.

Rende. U fute në lagjen e parë.
Po një plumb të la ashtu të kacavjerrë ndaj
lisit të lirisë,

si ky qytet i gurtë
i është kacavjerrë malit.

Faqja të preku muret e ngrohtë të qytetit.
Ngjaje ashtu sikur i kishe vënë veshin kësaj toke
dhe kërkoje zhurmët e detit pas malesh.
Gjithmonë kishe ëndërruar që gjumin e fundit
ta bëje nën flokët e ullinjve dhe portokalleve.

Dhe re këtu, fare pranë lirisë.
(Vetëm disa brohoritje të ndanin).

Netëve tona mblidhen burrat në një rreth
dhe s'harrojnë kurrë të këndojnë edhe këngën tënde.
Trupin tënd
Ka kohë që e kemi vendosur kundrejt detit,
pikërisht aty ku doje ti, Cano.

13449

EPISOD

Saranda, si një hënë e prerë
është ngulur në tokë.
Në bregun e hënës —
shkumba e valëve
dhe stërkalat e dritës bien si lotë.

Mes dallgësh m'iku fëmijnia
rrugëve të hënës, oborreve.
Hyni ju vite në vargjet e mia,
këmbëzbathurat vite,
pas valëve dhe lodrave.

Më ndodhte, bomba të kuqe të zija me
duar
së bashku me lulet e kuqe.

O tufë e çuditshme, e bashkuar
me bomba, zambakë, burbuqe!

Unë me lotë e përçolla dhe një shok
sepse tufa, duke i marrë erë,
magji i bëri,
tufa e kuqe bërtiti kaq fort
sa deti kundruall u drodh i tëri.

DHJETËRA ANIJE PESHKATARËSH

Dhjetëra anije peshkatarësh janë mbledhur në
liman.

Dhjetëra katartë lëkunden
në sfondin e kuqërremtë të horizontit.
Andej -këndej lëvizin peshkatarë
të veshur me mushamenj të zinj.
Shih' si reflektojnë nga drita e mbrëmjes,
shikoi mushamatë e rrahura nga stuhitë e egra
detare,

mushamatë e lëpira nga dallgët.
Rreth e rrotull kundërmon aromë peshku.
Shpejt, ngrini spirancat. Na pret prapë deti.
Shpejt, do të shkasim përsëri
sipër zemërimit të dallgëve të mesnatës.
Përsëri mjegullat
do të ndehen si pëlhura në katartet tona,
Pra, shpejt.

Dhe spirancat u mblodhën,
u ngritën shkallët e drunjta,
u ndezën motorët
dhe anijet çanë më dysh ujërat e muzgut...

STINA E AKSIONEVE

Zërat, brohoritjet, urratë
mbështillen si një erë,
vërtiten rrotull mitingjeve dhe sulen pastaj
duke rendur sipër trenave dhe autobuzëve.

Stina e aksioneve me breshëri brohoritjesh,
valëvitje flamujsh,
lajmëroi ardhjen e saj.
Kjo stinë me vrull po rend hapësirave.

* * *

Ja qytezat. Qytezat në gjunjët e maleve.
Ne erdhëm e gjithë orteku i brohoritjeve
që sollën nga larg, u përplas në muret prej
pupuliti.

Vërshoi rrugëve të pashkelura.
Hapi dyert. Çdo metër kub i hapësirës
u mbush me zërat tanë.
Për qytezat kjo ishte frymëmarrja e parë.

* * *

Ne jemi skuadronet e para të stinës së re.
Si drita të kuqe
vumë në ballë emra heronjsh.

Kjo stinë do të rrjedhë,
do të gurgullojë brigjeve të kohës,
plot shkumbë dritërash dhe gjelbërimesh,
si dhjetëra pranvera të ngjeshura
në një pranverë të vetme.

PËLLUMBAT

Po të guxonit të thoshnit, nëna,
se nuk venit nuse aty ku ju shpinin,
në shpirtin tuaj gjëmonin fjalë të rënda,
siç gjëmojnë ortiqet në lugjet e thella dimrit.

Dhe dimri i zakonit s'ështëte
duke lëshuar ortiqe
në ditët tuaja dhe në ato që vinin.
Qëndisnit parreshtur pëllumba në punëkryqe,
po prapë ju penguan fluturimin .

Po dimri i egër po shkrin
dhe kanë lulëzuar motrat tona,
pëllumbat e ditëve tuaja të rinisë
hynë e dalin parreshtur në dhoma.

LUFTËTARI I GURTË

Të heshtur, të rëndë,
pranë dhjetëra skulpturash,
kokash të mermerta, ulën një shkëmb.

Skulptori u afrua, i ra me çekiç
dhe në fytyrë i ndriti buzëqeshja,
ju kujtua shkëmbi mes erërash dhe stuhish.

Vendosi një shkallë.
Hipi. Filloi nga puna.
Cifla guri binin me zhurmë përposh
dhe vinte ndaj tij,
që nga thellësi e shkëmbit, (thellësi e kohës),
një luftëtar i vrëjtur dhe serioz.

Hapat e tij ndiheshin të qarta
nën ritmin e përditshëm të daltës çak-çik.
Zgjateshin kureshtarë koka allçish,
Zgjateshin kureshtarë koka mermeri.

Dhe një ditë, ashtu i vrëjtur,
si nga një lëvozhgë e gurtë,
doli luftëtari.

Çast solemn. Skulptori u hoq mënjanë.
Si simbol i përjetshëm ngrihej përpara
figura e shqiptarit të ngjeshur me armë.

Dhe pa dashur tha se s'bëri gjë tjetër,
vetëm e zhveshi nga shkëmbi i madh,
se çdo shkëmb, çdo gur i atdheut,
në zemër ka një luftëtar.

POETI PARTIZAN

Po unë, ç'kam në këto netë të gjata
nën afshin e këngëve të barutit?
E ndjej të bulojnë sythet e vargjeve,
lirikat si lulet shpirtin të ma zbutin

Dhe një tufë lirikash, si një tufë me lule,
do ta këput nga kjo pranverë ndjenjash...

Po dimri akoma me netët e ërrëta
ulërin e sillet nëpër predhash.

Dhe endem kështu nga një betejë në
tjetrën,
nën afshin e këngëve të barutit.

PËR TY

Më në fund, e dashur, ja dhe vargjet për ty.
Mos ke pritur e shqetësuar?
Unë brodha larg;
tërhoqa topa n'errësirë me ushtarët,
vendosa piketat e një qyteti buzë Jonit...

E di, ti s'rende plot ankth rrugës së vargjeve,
vetëm për të më gjetur,
si dashnoret e kalorësve
në muzgjet e luftërave.
E di, e dashur, ti je vetë mes rreshtash,
ecën duke u pleksur me fashat e dritave,
me klithmat e sirenave që çajnë hapësirën.

E marr me mend se unë jam diku më përpara
dhe nxiton të më arrish,
e di se dashuria dhe e ardhmja takohen në një
pikë
dhe rend drejt s'ardhmes dhe dashurisë
kaq e sigurt, e dashur.

INAUGURIM

Sonte, hëna dhe yjet (qielli i gjithë)
do derdhen mbi liqen.
Do lëvizin ujërat drejt kataraktit,
si një kope dallgësh poshtë do kërcejnë.

Do futen ujërat në turbina dhe sonte,
për herë të parë, në shtëpitë tona
hëna dhe yjet do të llamburijnë.

Ja, sonte telat po përcjellin hënën dhe yjet,
Shikoni: Nga kjo peshë lumturie
telave ju është harkuar shpina!

MARSH REVOLUCIONI

Përplasni hapat fort në tokë
sa dhe ciejt si xhama të dridhen,
që hapat tona të jenë të shkathta
t'i flakim të gjithë paragjykimet.

Çdo mendim i botës së vjetër
nën këmbët tona të vdesë.
Përplasni hapat, përplasni hapat
me ritmin vigan të së resë.

Për ne e ardhmja s'është një gaz
në fund të shkretëtirës së shekujve.
Përditë e shohim tek hedhin shtat
bisqet e saj të hekurt.

Dridhen uzinat nga duart e punëtorëve,
oxhaqet lëkunden si pishtarë në qiej.
Përpara do ecim gjithmonë mes kohërave,
me pishtarë oxhaqesh për të ndezur diej.

Pra, shtrijeni hapin fort në tokë!
Andej ku partia dorën zgjat.
Vet agrepat e lodhur të kohës
duke gulçuar na ndjekin pas.

MARGARITË E KRISTAQ TUTULANIT

... Ngritën pushkët.
Ju ngritët kokën.
Buzë greminës së natës patë të mbinte
si një lule ylli i mëngjezit.

S'ju lanë ta shihnit qiellin
veçse të bërë copa-copa nga hekurat e qelisë.
Asnjë rreze ylli s'lanë të arrinin te ju
Për t'i parë në dritën e tyre
fytyrat tuaja të gjakosura.

Tashti ju ngritën pushkët.
sepse nuk mund të shkulinin dot
rrënjët e shpresave tuaja.

(Jua dërmuan trupin,
jua shkallmuan fare trupin
me thundrat e tyre të hekurta,
jua bënë trupin gërmadhë.

Po për çudi, mbi këto gërmadha,
harliseshin përsëri bisqet e besimit tuaj të
madh.)

.....

Nga larg, nga ylli i mëngjezit, frynte një erë.

LIRIKË

Kjo mbrëmje në hapësirën e Tiranës
u tret në frymëmarrjen e mbushur me drita
të qytetit, rreth pelikanëve të bardhë
në basenin e parkut me ujët e qetë.

Kalova male që ngrihen të stuhishme,
humnera të mjegulluara,
për të zbritur te kjo mbrëmje e qelqtë.

Pashë mimozat buzë trotuarëve
të mbushur me cicërimën e gëzuar të
fëmijëve,
djem si veten, me këmisha të bardha
të shoqëroheshin me vajza
që i ngjajnë së dashurës sime,

dhe kudo më ndoqi fytyra e saj
si në një napë t'argjentë, në mes të muzgut
të flokëve.

Dëgjova nën kolonat e mermerta
edhe këngë labe, ndjeva se ndodhesha
nën një strehë të dridhshme e të pakapshme
ngjarjesh tronditëse,
pashë nga kjo strehë
vite të ruajtura si kopshte
në shpirtin e popullit,

heronj të lëronin dheun
dhe e ndjeva veten të rritur
nga drithi i këtyre brazdave.

Eca përmes sigurisë së njerëzve
që çajnë në jetë me shpatullat e ndershmërisë
së tyre,

kalova mes kryqëzimeve të përshëndetjeve,
m'u duk vetja si një pjesë e kësaj mbrëmjeje,
ndjeva se po ecja
në pllakat e trotuarëve të qytetit tim
dhe të të gjitha qyteteve.

Tani s'kam ç'të them në këtë mbrëmje të
qelqtë,
veçse të shtoj së fundi se të gjithëve ju dua.
E di se e dashura ime,
nën velin e mjegullt të gjumit
me sytë e mbyllur
si dy pëllumba të heshtur,
do më kujtojë mua.

K E S H T J E L L A

Ja Rozafa.

Gjiri i bardhë i skalitur në hyrje të
kështjellës,
pikon qumësht.

Lindnin shekujt,
pinin qumësht te ky gji i konës.
pinin mushtin e lirisë,
që rridhte nga gjëndrat
e tokës
dhe rendnin pastaj mes luftërash,
rendnin mes lavdish.
Shekujt tanë luftarakë, të paepur.

Qëllonte që vinin në kështjellë
tërë gjak, gjysmë të vdekur.

Atëhere shtrëngonte musklat atdheu,
shtrydhte gjirin.

Ata çoheshin, kapnin armët
dhe prapë në luftë vinin.

Mure dhe shekuj të rrëzuar.

Mjegull. Midis gurëve

bari i gjelbër i kohës sonë mungullon.

NATË SHIRJESH

Nata u ul mbi fushë.
(Tërë ditën vajzat me drapër
mblodhën në duaj hapësirat e verës.).
Ne me flokët e lidhur me shami
derdhim duajt në grykën e maqinës.

Maqina si qenje mbllaçitet pa rreshtur,
kërcet dhëmbët e mbushur me kashtë.
Brigadieri le cfurkun
dhe ashtu serioz
kontrollon grurin që derdhet në thasë.

Edhe kur nata të ngrihet e t'iki
e djegur nga dritat,
këtu do të na gjeni me flokët e lidhur
nën zhurmë motorësh dhe rripash.

PLUGIMET E REJA

Brazdat me avuj të ngrohtë pas korrjes
palosen si dallgë nën plug.
Rri e kundroj nga fundi i ngastrës
siç kam kundruar detin tim në jug.

Dhe s'mund të largohem kurrsesi
pa ʻardhur brazdat gjer te këmbët e mia...
Ç'më bëri për vete ky det i ri,
det i plugimeve të reja.

AKUAREL

Dielli u ul në brazdat e dallgëve
si një lëmsh i artë, i bukur.
Dhe retë si lulkuqe vigane,
kanë mbirë në horizontin e skuqur.

Eja, e dashur, anës së detit
me sytë e mirë si qielli,
drejt bregut dallgët rrokullisen
dhe çahen, përflakur nga dielli.

Ja, këtu do ngremë qytetin.
Më të blerët se ky s'do të ketë,
mbi të kopshtie portokallesh
dhe radhë brezarësh¹⁾ gjer te retë.

Do vijë një mëngjez
dhe këtu do ulet
qyteti ynë në drita i larë.

1) taracash.

NË LIMANIN E DITËVE TONA

Në det bëhej luftë.
Joni rrudhte ballin
dhe dallgët suleshin drejt bregut
duke sjellur jehonën e luftës.

copëra katartesh, pëlhura të gjakosura,
duke përplasur në shkëmbenjtë e kripur
agimet e purpurta.

Fundit të detit, si një muze shekujsh,
i dhuronin, dallgët, objekte të reja.
Ngrinin kokën dhe prapë suleshin drejt
bregut,
dhe prapë sillnin lajme betejash.

Dallgët e shkumëzuara të shpirtrave të tyre
nënave u shkallmonin brinjët.
Prisnin, prisnin me vite
nënat, që nga pritja u thinjën.

Këngët që ngrinin
ishin sikur të ndërtonin barka
dhe t'ju vinin djemve pranë.
Çanë këngët përmes stërkalash,
këngët e djemve që ranë.

Çanë këngët dhe të shtyra nga koha
në limanin e ditëve tona hynë.
Zbresin nga anijet detarët e vjetër,
zbresin me këngët dhe drejt nesh vijnë.

BORE E PARE NË JUG

Dukej sikur mbi gjithë çatitë e kudo
mbrëmë frynin erëra.

Tufa mjegullash
rrëzonin kolonat e tymit nga oxhaqet.
Në llambat e rrugëve,
mbi shkumën e ndriçuar të detit
silleshin parreshtur
mijëra flutura të çuditshme bore.

Ku ta dinin mbrëmë fëmijët, se të nesërmen,
në vend të mjegullave,
mbi çatitë, mbi qepallat e dritareve,
mbi katartet e anijeve,

mbi gjithë qytetin e tyre,
të ngritur në zgrib të zhurmave shkumore të
Jonit,
do të ngelej një pudër e shndritshme bore?

Qyteti mbrëmë ishte fundosur
nën një fërfëritje fluturash...

O si fërfërinte mbrëmë bora
mbi supet e punëtorëve të portit,
si vinte që larg zhurma e mbytur e fabrikave,
sikur brenda tyre vërtiteshin të dërmuara gjithë
erërat,
gjithë stuhitë dhe mjegullat.

Po, kur ra mëngjezi,
punëtorët shkelën mbi borën e heshtur
Larg, hëna si një apostrofë,
ulej mbi shkrimin e një parulle drite.
Atyre ju rrihte zëmra, ju rrihte zemra,
si një pëllumb ju çukiste në brinjë.

Pas pak, mbi borë, do vërshonin fëmijët.

GJAHTARËT E PESHKUT

Duke kaluar n'udhëkryqje fenerësh,
nga gjiri i natës një motobarkë
mbërriti n'ujërat e kaltërta të mëngjezit.

Dëgjohen zëra të përgjumur
që mpleksen me rrjeshtat e qullura.
zhurmë zinxhirash,
spiranca që humbet poshtë ujërave
dhe çapat e rënda të peshkatarëve në mol.

Kapidani është i pari i tyre.
Sa herë që shfaqen mbi hone ujore,
zëri i kapidanit i trashë, i ngjitur,
në zemër ju hodh spirancën e shpresës.

Të sigurtë atëhere tërheqin rrjetat,
rrjetat e rrahura nga stuhia.

Çaj në përmes yjeve të rëna mbi ujëra,
udhëkryqëve të fenerëve, buzë stuhive
të mbushur me peshq.

T a n i p e s h k a t a r ë t,

të mbështjellë nga era e peshkut, e dallgëve,
ecin drejt shtëpive
duke hedhur këmbët në bulevardin e qytetit,
si në bordin e një anije vigane.

Në zemër kanë një këngë të ashpër,
një këngë të ashpër për detin,
për detin dhe gjuetinë.

DREJT HAPËSIRAVE TË PASTRA TË LIRISE

...Ecin. Përballë lisat.

Përballë malet pak çaste pas krismave,
pas betejave
me tymin e heshtjes që ngjitet dalëngadalë mbi
kreshta.

Dëgjohen tingujt e ndonjë zileje.
Këmbët e mushkave hapin gropa të vogla zhurme
në zallin e natës.

Gjumi rëndon mbi qepallat,
mbi kurmet e raskapitura,
gjumi rëndoi kaq shumë mbi shokun e plagosur,
saqë e mori për gjithnjë
të mbështjellë me dhimbje dhe ëndërra.

Atëhere gërmuan me bajoneta një varr.
Balta ishte e zezë, balta avullonte.
Dy shoqe e futën brenda, i bashkuan gjymtyrët.
Pastaj njëri pas tjetrit kaluan të gjithë.
Të gjithë hodhën nga një grusht dhe të ngjyer
me muzgun e mbrëmjes,
të mbrujtur me dashurinë e duarve të ashpra.

I fundit kaloi komisari,
i fundit komisari vendosi mbi gjoksin e tij
një boçe lisi
dhe po i fundit komisari tha:

«Le të mbijë lisi,
Le t'i lëshojë rrënjët thellë
në gjoksin e tij, në zemrën e tij.

Të mbijë lisi.
t'i ndejë degët e tij në të nesërmen,
të thithin mushkëritë e tij
ajrin e hapësirave të pastra të lirisë.
Le t'i çojë rrënjët thellë në zemrën e shokut,
në zemrën e malit,

që asnjë stuhi të mos i përmbysë malet dhe
shokët tanë.

Lamtumirë...»

Pa yjet.

Ishin çuditërisht të mëdhenj.

Në çast një këngë e fuqishme sikur e ngriti lart.

U rrënqeth.

Pastaj e rrëmbyen valët e këngës.

Ata janë shumë.

Fytyrat jua kanë përcëlluar luftërat,
shikimin, jua kanë mprehur shënjestrat.

Shumë bien.

Të gjallët luftojnë me pushkë.

Të rënët në zemër të të gjallëve.

Ata kanë një buzëqeshje të heshtur, të menduar,
një buzëqeshje që do të hapet si trëndafil
n'agimin e një dite me diell.

Flen ku t'i zejë nata.
Mbështetin kokën mbi një gur
dhe përnjëherë i ze gjumi.
(Nga ana tjetër mbështet kokën e saj vdekja.)
Shtyjnë me supe dyert e parafytyrimeve
dhe hyjnë në ditët tona.
Enden qyteteve të kaltëra

E nesërmja i gjen në betejë.
E nesërmja vjen me zhurmën e pushkëve,
me maqina të shkatërruara,
me helmata të shpërndara mbi barin e përgjakur,
me fjalë të huaja të lëna përgjysmë nga vdekja.

E nesërmja shpërthen mijëra brohoritje
si mijëra shpërthime rrezesh,
në horizontet e lirisë.

PJERGULLA

Kjo pjergull
që më thërret çdo mëngjez nga dritarja,
zbret poshtë viteve me rrënjët e ngulura
në fëmijninë time.

Atëhere
kur ne na linin n'oborret plot me mullaga,
kur iknin të mëdhenjtë të nxirrnin gurë nga mali,
kur mblidhnin rërën e detit
edhe ne të vegjlit
e kuptonim se ndërtohej jeta që nga themeli.

Ç'të bënim?
I shihnim të gjitha këto
dhe imitonim të mëdhenjtë;
ndërtonim «shtëpira»

dhe bëheshim prindër të fëmijëve prej leckash.
Shikonim se si çdo ditë
rrezoheshin barakat dhe karakatinat,
si ngrihej qyteti që mbrëmjeve lëshonte
pingul mbi det dritën e neoneve
sa që besojë se i gjithë ishte ndërtuar
mbi këto shtylla drite.

U shembën dhe netët e shtrembra të sokaqeve.
Vetëm këtë pjergull e ndihmuam të kacavirrej
në dritaren tonë të re.

... Dhe tashti çdo mëngjez
zgjat duart e saj të gjelbra
duke gërvishur një shushurimë në xham.

Unë hap dritaren
dhe së bashku me zërin e fuqishëm të ditës,
me vërshimin e ajrit të pastër
që nis nga gjiri i mbushur me anije,
ndjej të ushtojnë gjithë zërat e fëmijnisë së largët
në gjurmët e këngëve partizane.

E di, mullagat e oborrit tim,
i ndrydhën farat e tyre nën peshën e asfaltit.
Bredhjet shkëmbinjve buzë ujërave të detit.

peshqit, grepat e punuar me karfica,
të gjitha, të gjitha ngelën aty
nën peshën e fuqishme të ditëve tona.

Tashti dhe vetë jam ndërtonjës.

Asgjë nuk kujtoj me aq nostalgji.
Vetëm çuditem si shpërtheu kështu
kjo epokë e furishme e partisë
si e ngriti jetën time kaq lart
që unë të ngul bloqet e ëndrrave të mia
në rrugët e gjëra të këtyre ditëve.

Çdo ditë që gdhin
më thërret me veshjen e saj të blertë,
me erën e suvasë të hedhur në muret e ndërtesave
që qëndrojnë akoma në skela.
Dhe unë nisem. Më thërret jeta.
Kështu, çdo mëngjez.

Pjergulla e dritares sime
do të gjelbërojë e shëndetshme.

Ajo do të thithë gjithmonë nga rrënjët e fëmijnisë,
nga gjithë vazhda e ditëve të mia,
poshtë asfalteve, apartamenteve,
mbi vetë rrugët
gjithë kujtimet, gëzimet e jetës sime
dhe do të m'i derdhë me shushurimë në xham.

Unë gjithmonë do të hap dritaren
i ndjellë nga kjo thirrje,
do t'i hedh një sy gjirit të mbushur me anije
dhe gjithmonë do të rend drejt jetës.

PASQYRA

Kam sjellë	3
Shqetësim pranveror	5
Pashë si po përcillnin në banesën e fundit një veteran.	8
Shqipëria	10
Partisë sime	12
Kënga e gjelbër	13
Kënga e Cano Hajdinit	15
Episod	18
Dhjetëra anije peshkatarësh	20
Stina e aksioneve	22
Pëllumbat	24
Luftëtari i gurtë	25
Poeti partizan	27
Për ty	28
Inaugurim	29
Marsh revolucioni	30
Margaritë e Kristaq Tutulanit	32
Lirikë	34
Kështjella	37
Natë shirrjesh	39
Plugimet e reja	40
Akuarel	41
Në limanin e ditëve tona	42
Borë e parë në jug	44
Gjahtarët e peshkut	46
Drejt hapësirave të pastra të lirisë	48
Pjergulla	52

53.394

BIBLIOTEKA E SHKENCËS
TUTULANIT